



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E AELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ZËVENDËSKRYETARI

Nr. 2514 / 2 Prot.

Tiranë, më 18.02 2026

URDHËR

Nr. 41, Datë 18.02 2026

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR TRAJTIMIN ADMINISTRATIV TË
PRETENDIMEVE PËR HAKMARRJE DHE MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT
NË GJYKATËN E AELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM”**

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores “Për Trajtimin Administrativ të Pretendimeve për Hakmarrje dhe Mbrojtjen e Konfidencialitetit” në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen të gjithë nëpunësit e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
3. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE

ILIBA BEZAT



RREGULLORE

“PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË PRETENDIMEVE PËR HAKMARRJE DHE MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT”

Neni 1 Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në Ligjin nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për trajtimin administrativ të pretendimeve për hakmarrje ndaj sinjalizuesve dhe zbatimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 96/2025, pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Hakmarrje” është çdo veprim ose mosveprim, i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, përfshirë kërcënimin, i ndërmarrë në kontekstin e punës, që shkakton ose mund të shkaktojë dëm të pajustificuar ndaj sinjalizuesit, si pasojë e sinjalizimit të bërë prej tij në përputhje me Ligjin nr. 96/2025.
2. “ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, autoriteti kompetent për shqyrtimin e kërkesave për mbrojtje nga hakmarrja dhe vendosjen e masave të mbrojtjes sipas ligjit.
3. “Mbrojtje” është mbrojtja që i garantohet sinjalizuesit nga çdo formë hakmarrjeje, në përputhje me mekanizmin dhe procedurat e parashikuara në Ligjin nr. 96/2025.
4. “Njësia përgjegjëse” është struktura e caktuar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e ngarkuar me administrimin dhe hetimin administrativ të sinjalizimeve, në përputhje me Ligjin nr. 96/2025 dhe këtë rregullore.
5. “Autoritet publik” ka kuptimin e parashikuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
6. “Sinjalizim” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit pranë njësisë përgjegjëse ose ILDKPKI-së për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, në fushat e parashikuara nga Ligji nr. 96/2025, të kryera në kontekstin e punës.
7. “Sinjalizues” është çdo individ që, në një kontekst pune pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, aplikon për një vend pune, është ose ka qenë në marrëdhënie pune, pavarësisht nga natyra dhe kohëzgjatja e saj, me ose pa shpërblim, dhe që sinjalizon në mirëbesim shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, sipas Ligjit nr. 96/2025.

8. “Shkelje e mundshme e kuadrit ligjor” është çdo veprim ose mosveprim, fakt apo rrethanë për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim se përbëjnë shkelje të legjislacionit në fuqi, në përputhje me fushat e përcaktuara në Ligjin nr. 96/2025.

Neni 4

Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale që kryhen nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të trajtimit administrativ të pretendimeve për hakmarrje ndaj sinjalizuesve zhvillohen në përputhje me Ligjin nr. 96/2025 dhe, për sa nuk rregullohet shprehimisht prej tij, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat Gjykata cakton afate, përmbajnë paralajmërim të qartë mbi pasojat juridike të mosrespektimit të këtyre afateve.

Neni 5

Mbrojtja kundër veprimeve hakmarrëse

1. Sinjalizuesi që sinjalizon në mirëbesim shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, sipas Ligjit nr. 96/2025, mbrohet nga çdo formë veprimi ose mosveprimi hakmarrës të ndërmarrë ndaj tij në kontekstin e punës.
2. Veprime hakmarrëse konsiderohen, ndër të tjera:
 - a) shkarkimi nga puna;
 - b) pezullimi nga puna ose nga ushtrimi i detyrave;
 - c) transferimi i pajustificuar;
 - ç) ulja në detyrë;
 - d) ulja e pagës ose e përfitimeve financiare;
 - dh) mosngritja në detyrë;
 - e) vlerësime negative të pajustificuara;
 - ë) përjashtimi nga trajnime ose programe zhvillimi profesional;
 - f) intimidimi, ngacmimi, presioni psikologjik ose izolimi profesional;
 - g) diskriminimi ose trajtim i padrejtë;
 - gj) mosrinovimi i kontratës ose përfundimi i parakohshëm i saj;
 - h) dëmtimi i reputacionit ose përfshirja në lista që pengojnë punësimin;
 - i) përfundimi i kontratave për mallra ose shërbime;
 - j) anulimi i licencës ose i lejes së ushtrimit të aktivitetit;
 - k) referimi i pajustificuar për ekzaminim mjekësor ose psikiatrik;
 - l) kërcënimi ose tentativa për të ndërmarrë një nga veprimet e mësipërme.
3. Çdo akt hakmarrjeje është i pavlefshëm dhe nuk sjell pasoja juridike ndaj sinjalizuesit.
4. Mbrojtja nga hakmarrja zbatohet sipas mekanizmit dhe procedurave të parashikuara në Ligjin nr. 96/2025.

Neni 6

Paraqitja e kërkesës për mbrojtje

1. Sinjalizuesi që pretendon se është subjekt i një veprimi hakmarrës ka të drejtë t'i drejtohet drejtpërdrejt Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), në përputhje me Ligjin nr. 96/2025.

2. Paraqitja e kërkesës për mbrojtje pranë ILDKPKI-së nuk kushtëzohet nga paraqitja paraprake e saj pranë njësisë përgjegjëse të Gjykatës.
3. Në rast se sinjalizuesi i paraqet pretendimin për veprime hakmarrëse Gjykatës, ai informohet menjëherë për të drejtën për t'iu drejtuar ILDKPKI-së.

Neni 7

Trajtimi administrativ i pretendimit për veprime hakmarrëse

1. Në rast se Gjykata merr dijeni për një pretendim për veprime hakmarrëse ndaj sinjalizuesit, Njësia Përgjegjëse verifikon rrethanat në plan administrativ, duke administruar dokumentacionin dhe duke marrë sqarime nga personat përkatës, me qëllim vlerësimin e situatës organizative.
2. Nëse gjatë verifikimit konstatohet se janë ndërmarrë veprime organizative që mund të cenojnë të drejtat e sinjalizuesit, Gjykata mund të marrë masa organizative të përkohshme, me karakter të brendshëm administrativ, për të parandaluar përkeqësimin e situatës, pa cenuar dhe pa zëvendësuar kompetencën e ILDKPKI-së për vendosjen e masave të përkohshme mbrojtëse sipas Ligjit nr. 96/2025.
3. Sinjalizuesi informohet për të drejtën për t'iu drejtuar drejtpërdrejt ILDKPKI-së për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse.

Neni 8

Bashkëpunimi me ILDKPKI

1. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm bashkëpunon me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) në kuadër të shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse.
2. Gjykata është e detyruar të vërë në dispozicion të ILDKPKI-së, pa vonesë, çdo informacion, dokumentacion, provë ose sqarim të kërkuar, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e konfidencialitetit të sinjalizuesit.
3. Çdo qëndrim ose argument i Gjykatës paraqitet me shkrim, sipas kërkesës së ILDKPKI-së.
4. Gjykata zbaton pa vonesë masat e përkohshme dhe përfundimtare të vendosura nga ILDKPKI në përputhje me Ligjin nr. 96/2025.

Neni 9

Sistemimi në një strukturë tjetër të administratës

1. Nëse sinjalizuesi pretendon se është subjekt i veprimeve hakmarrëse dhe kërkon sistemim në një strukturë tjetër të administratës për të shmangur reagime armiqësore në mjedisin e punës, ai paraqet kërkesë me shkrim pranë Kryetarit të Gjykatës. Një kopje e kërkesës mund t'i paraqitet edhe ILDKPKI-së.
2. Gjykata, duke vlerësuar rrethanat konkrete, mund të marrë masa organizative të arsyeshme dhe proporcionale për sistemimin e përkohshëm të sinjalizuesit, pa cenuar të drejtat e tij, statusin apo përfitimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.
3. Marrja e kësaj mase nuk cenon kompetencën e ILDKPKI-së për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje dhe vendosjen e masave përkatëse sipas Ligjit nr. 96/2025.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit me urdhër të Kryetarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

